



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 215 Prot.

Tiranë, më datë 24.04.2026

VENDIM
Nr. 158 datë 24.04.2026

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 24.04.2026:

VENDOSI

1. Miratimin e kërkesës së **Znj. Rilinda Shehu** për pajisje me Licencë individuale në Projektim (P), në veprimtari ndërhyrëse në pasuri kulturore materiale në kategorinë (A): P/A/5, P/A/7;
2. Mosmiratimin e kërkesës së **Znj. Rilinda Shehu** për pajisje me Licencë individuale në Projektim (P), në veprimtari ndërhyrëse në pasuri kulturore materiale në kategorinë (A): P/A/1, P/A/2, P/A/3, P/A/4, P/A/6, pasi nuk plotëson numrin e projekteve në këto nënkategori, sipas përcaktimeve të VKM nr. 792/2020, Kreu II/“B”, pika 1, shkronja c);
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Endri HAXHIU

